




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 90/1 prot.

Shkodër më 10.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 2, datë 27.01.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja "n", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të VKM nr. 597, dt. 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, Kreu IV, pika 1, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", të ndryshuar, *shqyrtoi VKB Fushë Arrëz nr. 2, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025"*.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

